



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
TIRANË**

V E N D I M

Nr.76, datë 27.12.2007

**“PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.6, DATË
26.01.2001 “PËR VENDOSJEN E GJOBAVE NGA BASHKIA TIRANË”
(I NDRYSHUAR)**

Bazuar në Ligjin Nr.8652, dt.31.07.2000, neni 32, gërma "e", "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32, Ligjit nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), neni 3 dhe 5, vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.6, datë 26.01.2001 “Mbi vendosjen e gjobave nga Bashkia Tiranë”, (i ndryshuar me V.K.B.-në Nr.19, datë 11.03.2002), pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Transportit dhe e Qarkullimit Rrugor, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I

1. Pas pikës 1 të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.6, datë 26.01.2001 “Mbi vendosjen e gjobave nga Bashkia Tiranë (i ndryshuar), shtohet pika “1/1” me këtë përmbajtje:
“Niveli i gjobës në rastin e dëmtimit të bllokuesit të mjetit (clamps), do të jetë 10.000 lekë, duke shtuar dhe vlerën e dëmit”.
2. Në pikën 8 të Vendimit të këshillit Bashkiak Nr.6, datë 26.01.2001 “Mbi vendosjen e gjobave nga Bashkia Tiranë (i ndryshuar) pas fjalëve “vendosja e gjobave për pikat 1”, shtohet pika “1/1”.
3. Ngarkohet Policia Bashkiake dhe Drejtoria e Transportit dhe e Qarkullimit Rrugor, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sokol DERVISHAJ

K R Y E T A R